1. Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).

2. Diploma përkatëse, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal),kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose pr

Arianit R. Bytyqi

Tenderi i tij është i papërgjegjshëm:

Nuk ka dorëzuar dëshmi siç është kërkuar në faqet 17 të Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë (Kërk profesionale):

Kërkesa:
1. Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shl përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve.

Dëshmia:
1. Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës v (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (nga punëdhënësit– (kopje).

ARSYETIM

OE- për këtë kërkesë nuk ka prezantuar fare Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkr (origjinal) siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontratë.

Kërkesa
2. Zhvillues i Bazave të dhënave duhet ti ketë min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit ne Zhvillimin

Dëshmia:
Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).

OE për këtë kërkesë ka prezantuar një referencë për përvojën e punës nga Kompania Unisoft për Arian figuron se është i punësuar ne Unisoft me datën 01.09.2021, shto faktin qe edhe kontratën është lidhur lëshuar për përvojën e punës nuk pranohet për periudhën para datës 01.09.2021 ku i njëjti nuk ka qene Unisoft dhe rrjedhimisht nuk mund te lëshohet reference për përvojën e punës ne emër te punëdhënësv

Stafin tjetër te cilin e ka prezantuar ne ofertën tij personat me incialet (E.T.,F.G.,G.Z.,M.B.,Ç.P.) nuk e plotë

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES
Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotë 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës e

Radhë	Lënda / grupi: Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	InterAdria L.L.C., 810819336	244,260.00
2.	NOVUS SH.P.K., 600834065	256,256.56

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	InterAdria L.L.C., 810819336	-	ALI KELMENDI NR.28

	TENDERUESI	Informata në lidhje me gabimet ne llogaritje	Ars
1.	Arianit R. Bytyqi 810201294		
2.	InterAdria L.L.C. 810819336		
3.	NOVUS SH.P.K. 600834065		

Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit

	TENDERUESI	Informata shtese
1.	Arianit R. Bytyqi 810201294	
2.	InterAdria L.L.C. 810819336	
3.	NOVUS SH.P.K. 600834065	

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit në bazë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimin të ofertave, ka konstatuar se pë baze te dokumentacionit te prezantuar në tenderët e tyre shihet se, 2 ofertat janë të përgjegjshme, dh kurse një ofertë është e pa përgjegjshme dhe nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit.

Duke e marrë parasysh se kriter vlerësim ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimi më i ulët, komisio oferta me çmim më të ulët, e Operatorit Ekonomik "InterAdria L.L.C.., i cili ka ofruar çmimin më të l Komisioni i vlerësimit i rekomandon Departamentit të Prokurimit që këtë kompani t'a shpërblejë me k

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Arianit R. Bytyqi**

Sqarim hyrës

Parashtruesi i ankesës ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 23.08.2023, për të cilën AK me 30.08.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues dhe me tenderin e OE të rekomanduar për kontratë. Në vijim janë përshkruar pretendimet, rrethanat e çështjes për secilin pretendim dhe vlerësimi i ekspertëve bazuar në provat shkresore në procedurë.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së në lidhje me vendimin për eliminimin e OE ankues, përkatësisht arsyen e eliminimit që ka të bëjë me menaxherin e projektit.

Rrethanat e çështjes

Referuar njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 18.08.2023, lidhur me këtë pikë, AK ka vendosur që të refuzojë tenderin e OE ankues, me arsyetimin si në vijim: "[...] *Nuk keni dorëzuar dëshmi siç është kërkuar në faqet 17 të Dosjes se tenderit Njoftimit për kontrate (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe.ose profesionale): Kërkesa: 1.Menaxheri i projektit duhet te jete Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave*

kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve. Dëshmia: I. Diploma përkatëse , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit te projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi - (origjinal) Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit-(kopje). ARSYETTM Ju për këtë kërkesë nuk keni prezantuar fare Vendim për caktimin e menaxherit te projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi - (origjinal) ne ofe1ten tuja ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate."

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vendosur këkesën për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: *1.Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve*. Për këtë kërkesë si dëshmi është kërkuar: *1. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit-(kopje).*

Referuar vendimit të AK-së të datës 30.08.2023, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK në lidhje me këtë pretendim është përgjigjur si vijon: "[...] *Lidhur me pretendimet ankimore sa i përket menaxherit te projektit për te cilin është kërkuar mes tjerash edhe Vendim për caktim te menaxherit projektit , AK-MPB pas shqyrtimit te pretendimeve konstaton se kjo kërkesë nuk është përmbushur nga OE ankues pasi qe ne ofertën e dorëzuar nuk keni dorëzuar Vendim për caktim te menaxherit te nënshkruar dhe vulosur, andaj komisioni i vlerësimit me te drejt ka vendosur për eliminimin tuaj dhe i nijeti komision nuk ka përdorur nenin 72 te LPP për arsye se dokumenti ne fjale nuk mund te verifikohet ne mënyrë objektive se ka qene para datës se dorëzimit te ofertave siç parasheh LPP " Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do te aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencën e të cilëve është e fiksuar, para skadimit të fundit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive* andaj ne këtë pike pretendimi është i pa bazuar."

OE ankues ka dorëzuar dokumentet si vijon:

Dokumenti - Lista e Stafit; në të cilin specifikohet me numër se z.Fisnik Meha është menaxher i projektit me përvojë 12 vite.

CV e z.Fisnik Meha; në të cilën specifikohet përvoja e punës në kompaninë N.T.SH. UNISOFT nga muaji janar i vitit 2015 – dhe vazhdon, në pozicionin Project Manager.

Referenca për z.Fisnik Meha; në të cilën theksohet: Ky dokument dëshmon se grupi i operatoreve N.T.SH. "UNISOFT" për projektit e lartcekur. Lëshon këtë referencë dokument i cili ka marre pjese dhe ka kryer punët e parapara me sukses ne këto projekte te dhënët e te cilëve gjenden edhe ne CV: z. Fisnik Meha Menaxheri i projektit me përvoja të punës 12 vite. Më tej shënohet se Pjesëmarrja ne projekte (3 vite): I. Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik te Menaxhimit te Punëve me Studente ne Universitetin e Prishtinës, 2. Ofrimi i CMS dhe Dizajnimi, Ristrukturimi i UEB faqeve te UP-se, 3. Shërbimet e programit elektronik për testime gjate procesit te rekrutimit, 4. Krijimi i bazës qendrore se te dhënave për regjistrimin e personave te zhvendosur dhe te kthyerve 5. Mirëmbajtja e sistemit digjital te fakultetit për siguri publike.

Kontratën e punës për kohë te caktuar e lidhur në mes të: Arianit R. Bytyqi B.I (emrin tregtar: N.T.SH. "UNISOFT") dhe z. Fisnik Meha, ku i punësuar caktohet ne pozitën: Project Manager (Projekt Menaxher), Software and Database Devloper (Zhvillues i softuerit dhe i bazave te te dhënave). Në kontratë specifikohet se i punësuari themelon marrëdhënie pune, ne kohe te caktuar, duke filluar nga: 01.01.2023, deri me31.12.2023.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Eksperti shqyrtues dhe sqarojnë se në lidhje me menaxherin e projektit në dokumentin e listës së stafit të dorëzuar nga OE ankues dhe kontratën e z.Fisnik Meha, është evidentuar se i njëjti është i angazhuar si menaxher i projektit. Megjithatë, OE ankues nuk ka dorëzuar dëshminë përkatëse, përkatësisht vendimin për caktimin e menaxherit sikurse është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Andaj, sipas sqarimit të mësipërm pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së në lidhje me vendimin për eliminimin e OE ankues, përkatësisht arsyen e eliminimit që ka të bëjë me Zhvilluesin e Bazave te dhënave.

Rrethanat e çështjes

Referuar njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 18.08.2023, lidhur me këtë pikë, AK ka vendosur që të refuzojë tenderin e OE ankues, me arsyetimin si në vijim: "[...] *Kërkesa 2. Zhvillues i Bazave te dhënave duhet ti ketë min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit ne Zhvillimin e Bazave te dhënave. Dëshmia: Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit-(kopje). Ju për këtë kërkesë keni prezantuar një reference për përvojën e punës nga Kompania Unisoft për Arianit Bajrami mirëpo ne CV e Arianitit figuron se është i punësuar ne Unisoft me datën 01.09.2021, shto faktin qe edhe kontratën është lidhur me datën 01.01.2023, andaj referenca e lëshuar për përvojën e punës nuk pranohet për periudhën para datës 01.09.2021 ku i njëjti nuk ka qene ne marrëdhënie te punës me kompaninë Unisoft dhe rrjedhimisht nuk mund te lëshohet reference për përvojën e punës ne emër te punëdhënësve tjerë. Mbi bazën e kësaj Zhvilluesi i Bazave te dhënave nuk e plotëson kërkesës me dosjen e tenderit për përvojën e punës. Stafin tjetër te cilin e keni prezantuar ne ofertën tuaj me inicialet (E.T.,F.G.,G.Z.,M.B.,Q.P.) nuk e plotësoj kërkesën e dosjes se tenderit për përvojën e punës. Prandaj, nga arsyet e cekura me lartë, oferta juaj është refuzuar dhe nuk kalon ne vlerësimin e mëtutjeshëm."*

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vendosur kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: *2. Tre (3) Zhvillues i softuerit duhet të jen inxhinier i kompjuterikes ose Bachelor i Shkencave Kompjuterike min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne zhvillim te aplikacioneve 3. Zhvillues i Bazave të të dhënave duhet te jetë inxhinier i kompjuterikes ose Bachelor i shkencave kompjuterike – min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit ne Zhvillimin e Bazave të të dhënave.* Për këto kërkesa si dëshmi është kërkuar: *2. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri-(origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit–(kopje). 3. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e*

njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit-(kopje).

Referuar vendimit të AK-së të datës 30.08.2023, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK në lidhje me këtë pretendim është përgjigjur si vijon: "[...] *Lidhur me pretendimin për Zhvillues se softuerit se i njëjti i plotëson kërkesat me dosje te tenderit AK-MPB pas analizimit te pretendimeve dhe dokumentacionit te prezantuar ne oferte, shihet se i njëjti ne CV ka punuar ne disa kompani te ndryshme dhe nga data 01.09.2021 punon ne Unisoft, ndërsa referenca e dorëzuar për përvojën e punës nga Unisoft mund te merret vetëm për periudhën 01.09.2021 deri ne publikimin e njoftimit për kontrate 07.06.2023, Referenca e dorëzuar nga ju për periudhën para datës 01.09.2021 nuk pranohet dhe rrjedhimisht nuk mund te lëshohet reference ne emër te punëdhënësve tjerë. Si rrjedhoje ky pretendim është i pabazuar*."

OE ankues ka dorëzuar listën e stafit ku për pozitën Zhvillues i Bazave të të dhënave ka caktuar z.Adrian Krasniqi. Ndërsa personit të cilit i referohet AK në Letrën Standarde për tenderuesin e Eliminuar z.Arianit Bajrami, sipas listës së stafit, është caktuar në pozitën Zhvillues i softuerit.

OE ankues në lidhje me përvojën e punës të z. Arianit Bajrami ka dorëzuar dokumentet si vijon:

CV e z. Arianit Bajrami, në të cilin janë paraqitur informacionet për përvojën e punës si vijon nga data 11.10.2017 - 05.06.2018 ka punuar në pozitën Web Developer Junior në kompaninë Blic Solution me status Internship. Nga data 15.06. 2019 deri me date 24.09. 2020 ka punuar si Full Stack Developer in .NET MVCS and Core në kompaninë Cacttus.sha. Nga data 01.10.2020 deri me datë 01.07.2021 ka punuar në pozitën Mobile Developer Flutter (IOS.Android) në kompaninë eDev sh.p.k. Nga data 01.09.2021 – dhe vazhdon të punojë si Web Developer .NET MVC & Core në kompaninë Unisoft.

Kontratën e punës për kohë te caktuar e lidhur në mes të : Arianit R. Bytyqi B.I (emrin tregtar: N.T.SH. "UNISOFT") dhe z. Arjanit Bajrami, ku i punësuar caktohet ne pozitën: Software and Database Devloper (Zhvillues i softuerit dhe i bazave te te dhenave). Në kontratë

specifikohet se i punësuari themelon marrëdhënie pune, ne kohe te caktuar, duke filluar nga: 01.01.2023 , deri me31.12.2023.

Letër Reference, e lëshuar nga Unisoft ku theksohet se z.Arianit Bajrami z.Arjanit Bajrami User-interface dizajner ka përvojë 4 vjeçare. Më tej në referencë theksohet: Pjesëmarrja ne projekte (3 vite): 1. Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik te Menaxhimit te Punëve me Studente ne Universitetin e Prishtinës, 2. Ofrimi i CMS dhe Dizajn:imi, Ristrukturirni i UEB faqeve te UP-se, 3. Shërbimet e programit elektronik për testime gjate procesit te rekrutimit, 4. Krijimi i bazës qendrore se te dhënave për regjistrimin e personave te zhvendosur dhe te kthyerve 5. Mirëmbajtja e sistemit digjital te fakultetit për siguri publike.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Eksperti shqyrtues dhe teknik fillimisht theksojnë se AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, në arsyetim, gabimisht e ka bërë ndërlidhjen e personit z. Arianit Bajrami me kërkesën për Zhvilluesin e Bazave së të dhënave, duke qenë që i njëjti është propozuar si zhvillues i softuerit. Në lidhje me përvojën e punës si pikë kontestuese, sipas CV i njëjti ka përvojë në kompaninë Unisoft 1 vit e 9 muaj në pozitën Software and Database Devloper, ndërkaq punëdhënësi Unisoft i ka lëshuar referencë të njëjtit për pozitën User-interface dizajner me përvojë 4 vjeçare.

Eksperti Shqyrtues dhe Teknik sqarojnë se OE ankues nuk ka dorëzuar dëshmi për përvojën e punës konform kërkesës së AK-së "*Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit–(kopje)",* për faktin se OE ankues nuk mund të lëshojë dëshmi mbi përvojën e punës për një punëdhënës tjetër, poashtu dëshmia e lëshuar nga OE ankues ka mospërputhje me kontratën dhe CV e z. Arianit Bajrami, ku në CV dhe Kontratë shënohet se i njëjti është i punësuar në pozitën Zhvillues, ndërsa në referencë shënohet se i njëjti ka përvojë si User-interface dizajner. Andaj, sipas sqarimit të mësipërm pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se dëshmitë e dorëzuara për menaxherin e projektit të OE të rekomanduar për kontratë nuk plotësojnë kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosje të

tenderit.

Rrethanat e çështjes

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vendosur kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: *1.Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion ose Master i shkencave kompjuterike - min. 5 vite përvojë pune ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve*. Për këtë kërkesë si dëshmi është kërkuar: *1. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri-(origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit-(kopje).*

OE i rekomanduar për znj.Miranda Kajtazi ka dorëzuar dokumentet si vijon:

Diplomën e nivelit master në drejtimin Shkenca Kompjuterike, e lëshuar nga Växjö University, Suedisë, me datë 24.08.2007. ;

Diplomën e nivelit bachelor në drejtimin Shkenca Kompjuterike, e lëshuar nga Universiteti i Evropës Juglindore, me datë 17.07.2006.

CV në të cilën janë prezantuar informatat për shkollimin dhe përvojën e punës;

Referencën e lëshuar nga z.Bekim Hamiti, Administrator dhe Menaxher i Projektit të Sistemit Informativ për Burime Njerëzore, e nënshkruar dhe vulosur me vulën e Ministrisë së Administratës Publike. Data e lëshimit të referencës është 11.01.2018. Në referencë konfirmohet angazhimi i znj.Miranda Kajtazi si Menaxhere e Projektit.

Referencës e lëshuar nga OE Interadria me tekstin si vijon: *Kompania InterAdria me ane te kësaj reference konfirmon se punëtori Miranda Kajtazi, ka qene dhe është aktualisht e angazhuar ne projektet si me poshtë: PSMP.MPA.2B2.3.2015-6.23 me titull: Procurement of Development of the Human Resources Plannin, Module as part of HRMIS, including Training. 201-18-1168-221 me titull: Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ). MF201-18-1168-2-2-1 me titull: Mirëmbajtja e Sistemit të Pagave për të punësuarit publik dhe ngritja (upgrade) e sistemit të pagave në infrastructure të*

re 202.17.102.211 me titull: Përshtatja e SIMBNJ-së me pakon Ligjore për Administratë Publike. MF201-21-6450-215 me titull: Mirëmbajtja dhe avancimi.modernizimi i sistemit te pagave për te Punësuarit Publik. Miranda Kajtazi që është vendosur si konsulente në pozitën e Alternate Project manager.Quality Assurance Expert. Developer deri tani ka treguar performancë të mirë, kooperim të mirë me autoritetet kontraktuese në nivel te lartë, si dhe përgatitjen e dokumentacionit në harmoni me kërkesat kontraktuale. Ne vlerësojmë që punëtori në fjalë ka kapacitet që të vendoset në pozitën e zhvilluesit edhe në projekte më komplekse. Prandaj ne rekomandojmë udhëheqësit të departamentit të softwerit që të llogarisë në kapacitetet profesionale, komunikuese dhe etike të këtij të punësuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Eksperti shqyrtues dhe teknik në lidhje sqarojnë se bazuar në dështmitë e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, në lidhje me kriterin e shkollimit, dështmitë e dorëzuara plotësojnë kërkesën e AK-së, përkatësisht është dorëzuar diploma e nivelit bachelor dhe master në drejtimin - shkenca kompjuterike. Ndërkaq në lidhje me përvojën e punës, është dorëzuar CV me katërmbëdhjetë angazhime, prej të cilave dy angazhime në rolin e menaxherit, përkatësisht ndihmës menaxherit të projektit. Gjithashtu, është dorëzuar referenca e punëdhënësit (OE Interadria) në të cilën janë evidentuar përvoja në katër projekte, pa informata për vitet e angazhimit. Informacionet e prezantuara në CV në lidhje me përvojën, ku precizohet angazhimi në periudhën prill 2013 deri me dhjetor 2016 në rolin e menaxheres së projektit dhe angazhimi maj 2014 deri me dhjetor 2015 në rolin e zëvendës menaxher i projektit nuk plotësojnë kërkesën e AK për përvojë minimum 5 vite ne menaxhim projekteve dhe zhvillim te aplikacioneve. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 4

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm në lidhje me kërkesën për zhvillues, përkatësisht diplomat për znj.Ariana Kajtazi nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Rrethanat e çështjes

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vendosur kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: *2. Tre (3) Zhvillues i softuerit duhet të jen inxhinier i kompjuterikes ose Bachelor i Shkencave Kompjuterike min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne zhvillim te aplikacioneve 3. Zhvillues i Bazave të të dhënave duhet te jetë inxhinier i kompjuterikes ose Bachelor i shkencave kompjuterike – min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit ne Zhvillimin e Bazave të të dhënave.* Për këto kërkesa si dëshmi është kërkuar: *2. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri-(origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje). 3. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).*

OE i rekomanduar për znj. Ariana Kajtazi ka dorëzuar dokumentet si vijon:

Diplomën e nivelit bachelor në drejtimin Informatikë, e lëshuar nga Växjö University, me datë 13.11.2008

Certifikatë e diplomës për nivelin master në Teknologji, e lëshuar nga KTH Royal Institute of Technology, me datë 23.10.2007

Përgjigje në pretendimin ankimor 4

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se bazuar në dëshmitë e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, përkatësisht diplomës në nivelin bachelor në Informatikë është plotësuar kërkesa e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit në lidhje me shkollimin e znj.Ariana Kajtazi, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 5

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm në lidhje me kërkesën për zhvillues, përkatësisht diploma e dorëzuar për zhvilluesin z.Migjen Belegu, nuk përmbush kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Rrethanat e çështjes

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vendosur kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: *2. Tre (3) Zhvillues i softuerit duhet të jen inxhinier i kompjuterikes ose Bachelor i Shkencave Kompjuterike min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne zhvillim te aplikacioneve 3. Zhvillues i Bazave të të dhënave duhet te jetë inxhinier i kompjuterikes ose Bachelor i shkencave kompjuterike – min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit ne Zhvillimin e Bazave të të dhënave.* Për këto kërkesa si dëshmi është kërkuar: *2. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri-(origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje). 3. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë, CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit– (kopje).*

Referuar vendimit të AK-së të datës 30.08.2023, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK në lidhje me këtë pretendim është përgjigjur si vijon: "[...] *Lidhur me pretendimin tuaj ndaj OE te përzgjedhur fitues se i njëjta nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit sa i përket zhvilluesit te bazave te dhënave për personin me iniciale M.B. pas shqyrtimit dhe analizimit te lendes dhe raportit te vlerësimit kemi vërejtur se personi ne fjale nuk është trajtuar fare nga komisioni për arsye se ne këtë pozite është pranuar një person tjetër nga lisat e stafit te prezantuar nga OE i përzgjedhur fitues, andaj pretendimi është i pa bazuar*.

Në lidhje me shkollimin AK, me datë 30.06.2023 ka publikuar sqarime shtesë, ku në pyetjen e bërë nga një OE: *2. Tre (3) Zhvillues i softuerit duhet të jen inxhinier i kompjuterikes ose Bachelor i shkencave kompjuterike min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit ne zhvillim te aplikacioneve. 3. Zhvillues i Bazave të të dhënave duhet te jetë inxhinier i kompjuterikes ose Bachelor i shkencave kompjuterike – min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit ne Zhvillimin e Bazave të të dhënave. 2. Ju lutem te na konfirmoni se për piken 2 dhe 3, llogaritet si shkollimi relevante (i pranueshëm) Bachelor i Shkencave te Inxhinierisë Elektrike – Drejtimi Telekomunikacion,* AK është përgjigjur si vijon: *Jo, nuk është i pranueshëm. Zhvilluesi i*

softuerit dhe i bazës së të dhënave, duhet të jen inxhinier të kompjuterikes ose Bachelor të shkencave kompjuterike.

OE i rekomanduar për z.Migjen Belegu ka dorëzuar diplomën e nivelit bachelor në Shkenca të Inxhinierisë Elektrike.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se bazuar në dëshmitë e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, diploma e dorëzuar për z.Migjen Belegu nuk plotëson kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit në lidhje me drejtimin e studimeve.

Megjithatë, ashtu sikurse është sqaruar nga AK, në lidhje me kërkesën për zhvillues, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë të zhvilluesve të tjerë (A.K, B.V, L.K) andaj pretendimi është pjesërisht i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Shqarim, të gjitha pretendimet ankimore i ka shqyrtuar eksperti teknik.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Arianit R. Bytyqi**

Ardian Behra

Kreshnik Spahiu